

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Programi studimor: Prodhimtari dhe Automatizim



P U N I M M A S T E R I

Tema:

**Konstruktimi i veglës për shpimin dhe shtancimin
e pllakave SH 2215**

DESIGN OF DIES FOR BLANKING AND PIERCING OF SH 2215 PLATES

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Mirlind Bruçi

Kandidati:

Bach. Sahit Haxhosaj

Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
1. VEGLAT PËR PËRPUNIM TË LLAMARINËS	5
1.1. VEGLAT PËR SHPIM DHE SHTANCIM.....	6
1.2. ELEMENTET E VEGLËS PËR SHTANCIM DHE SHPIM.....	8
1.3. UDHËHEQJA E VEGLËS.....	9
2. AKTIVITETET GJATË KONSTRUKTIMIT TË VEGLËS	12
2.1. MATERIALI BAZË	12
2.2. SHFRYTËZIMI EKONOMIK I MATERIALIT	13
2.3. LLOJET E PRERJES SË SHIRITIT – LLOJET E HUMBJEVE TË MATERIALIT	14
2.4. SHKALLA E SHFRYTËZIMIT TË MATERIALIT	15
2.5. FORCA E SHTANCIMIT DHE SHPIMIT	15
2.6. ZVOGËLIMI I FORCËS SË SHTANCIMIT DHE SHPIMIT	16
2.6.1. Punimi i shtancuesit – shpuesit me gjatësi të ndryshme.....	16
2.6.2. Pjerrtësia e teheve të shtancuesit – shpuesit dhe matricës	17
2.6.3. Nxehja e materialit bazë (llamarinës).....	21
2.7. QENDRA E RËNDESESË SË VEGLËS.....	21
2.8. HAPËSIRA NË MES TË SHTANCUESIT – SHPUESIT DHE MATRICËS	22
2.9. MATERIALET E VEGLAVE	24
2.10. MATRICA PËR SHTANCIM – SHPIM	24
2.10.1. Llogaritja e dimensioneve të matricës.....	25
2.11. SHTANCUESIT DHE SHPUESIT	29
2.11.2. Llogaritja e shtancuesit dhe shpuesit në shtypje.....	31
2.11.3 Llogaritja në epje	31
2.12. PLLAKA UDHËHEQËSE.....	33
2.13. PLLAKA MBAJTËSE.....	33
2.14. NDËRMJETPLLAKA.....	34
2.15. ELEMENTET PËR PËRCAKTIMIN E GJATËSISË SË HAPIT TE LËVIZJA ME DORË E SHIRITIT.....	35

2.15.1. Centruetit	35
2.15.2. Kufizuesit (thikat) anësor	36
2.16. KONSTRUKTIMI I VEGLËS	37
TABELAT	39
PËRFUNDIMI.....	63
LITERATURA.....	65

HYRJE

Përpunimi me deformim plastik i metaleve se teknologji prodhimi është njohur dhe përdorur prej shumë kohësh.

Përmes kësaj teknologjie njerëzimi siguronte mjetet dhe veglat e mbrojtjes së vendit dhe të punimit të tokës.

Kjo metodë prodhimi është njohur dhe është përdorur që në lashtësi në vendin tonë nga ilirët. Për këtë dëshmojnë zbulimet dhe studimet në fushën e arkeologjisë. Ilirët kishin njohuri teknike mbi minierat dhe metalurgjinë. Ata ishin mjeshtrë të shquar në punimin e arit, argjendit dhe hekurit.

Përpunimi me deformim plastik është metodë e përpunimit të metaleve pa heqje ashkle. Kjo metodë e përpunimit ka përdorim të gjerë në përpunimin e detaleve që përdoren në amvisëri, makineri, elektronikë, industri ushtarake, etj.

Përparësitë e përpunimit me deformim janë:

- mundësia e prodhimit të shumë detaleve me një hap punues,
- kualiteti i lartë dhe saktësia e madhe e detaleve të prodhuara,
- shpenzimet janë të vogla,
- mundësia e lartë e automatizimit të prodhimit, etj.

1. VEGLAT PËR PËRPUNIM TË LLAMARINËS

Veglat për përpunim të llamarinës janë vegla për përpunim pa heqje ashkle dhe në varësi nga metoda e përpunimit ndahen në vegla për:

- prerje të llamarinës,
- shtancim dhe shpim,
- përkulje,
- kuposje.

Forma fillestare e prodhimit të artikujve nga llamarina mund të jetë: pllakë, shirit ose shirit pafund. Veglat për përpunimin e llamarinës përbëhen nga:

- Pjesa e epërme (e lëvizshme) dhe
- Pjesa e poshtme (e palëvizshme).

Këto pjesë përqendrohen me ndihmën e udhëzuesve.




Fig. 1. Vegla me udhëheqje të kombinuar:

1÷11 elementet konstruktive të veglës me udhëheqje të kombinuar




Fig. 2. Lloje të veglave për përpunimin e llamarinës

1.1. VEGLAT PËR SHPIM DHE SHTANCIM

Veglat për përpunimin e llamarinave grupohen në tri grupe:

- a) Veglat me precizitet të lartë,
- b) Veglat me precizitet të mesëm,
- c) Veglat e thjeshta.

Kualiteti i sipërfaqeve të detaleve që prodhohen me shtancim dhe shpim është IT 11 ÷ IT 8.

Përpunimi me shpim-shtancim është metodë e përpunimit me deformim pa heqje ashkle dhe futet në grupin e metodave për përpunimin e llamarinës. Dallimi në mes shpimit dhe shtancimit qëndron në detalin e prodhuar, ku te shpimi detali që shpohet është mbeturinë ndërsa pjesa tjetër e mbetur është detali i prodhuar ndërsa te shtancimi pjesa që shtancohet është detali i prodhuar ndërsa pjesa tjetër e mbetur është mbeturinë.




Fig. 3. Makina për shtancim dhe shpim




Fig. 4. Dallimi në mes shpimit dhe shtancimit

Vegla për shtancim dhe shpim bie në grupin e veglave për përpunimin e llamarinës. Kjo vegël ka për detyrë të prodhoj detale me kualitet dhe saktësi dimensionale të kërkuar.

Prodhimi i detaleve në këto vegla mund të kryhet me disa operacione (vegla progresive) ose vetëm me një operacion (veglat speciale-me renditje vertikale të operacioneve).




Fig. 5 a) Vegla me renditje horizontale dhe b) vertikale të operacioneve

1.2. ELEMENTET E VEGLËS PËR SHTANCIM DHE SHPIM

Elementet e veglës grupohen në tri grupe:

- themelore(bazë),
- ndihmëse dhe
- lidhëse-bartëse.

Elementet e veglës për shtancim dhe shpim janë:

- elementet standarde të makinerisë së përgjithshme (bulonat, kunjat për centrim, sustat etj),
- elementet standard konstruktiv të veglës (shtëpiza, shtyllat për udhëheqje, dorëzat për lidhjen e veglës për makinë etj),
- elementet të cilat janë pjesërisht ose plotësisht të standardizuara (pllakat për udhëheqje dhe ndërmjet pllakat, elementet për kufizimin e hapit të shiritit, elementet për udhëheqjen e shiritit, elementet për centrim etj),
- elementet të cilat varen plotësisht nga gjeometria e detalit (në këtë grup bëjnë pjesë elementet aktive punuese të veglës).

1.3. UDHËHEQJA E VEGLËS

Veglat për shtancim dhe shpim duhet të kenë:

- saktësi të përpunimit,
- qëndrueshmëri të lartë,
- prodhueshmëri të lartë etj.

Udhëheqja e veglës ka për detyrë që distancën në mes teheve prerëse të elementeve prerëse (patricë – matricë) gjatë gjithë procesit të shpimit dhe shtancimit ta mbajë konstante.

Në varësi nga udhëheqja, veglat ndahen në:

- veglat pa udhëheqje (veglat e hapura) – në këto vegla udhëheqja varet nga saktësia e rrëshqitësit të presës, saktësia e prodhimeve është $+0,2$ mm,
- veglat me udhëheqje me pllakë – në këto vegla pllaka përpos që bënë udhëheqjen shërben edhe për largimin e shiritit nga elementet aktive të veglës, pllaka për udhëheqje punohet nga çeliku konstruktiv (St 42-2 – St 70-2), saktësia e prodhimeve është $+(0,08 \div 0,15)$ mm,
- veglat me udhëheqje me shtylla – në këto vegla udhëhiqet e tërë pjesa e sipërme e veglës, largimi i shiritit nga elementet aktive duhet të bëhet me elemente shtesë, shtyllat punohen nga çeliku karbonik për çimentim (C 10 – C 15), saktësia e prodhimeve është $+(0.05 \div 0.10)$ mm,
- veglat me udhëheqje të kombinuar – në këto vegla udhëheqja bëhet me pllakë udhëheqëse dhe me shtylla udhëheqëse.




Fig. 6. Vegla pa udhëheqje 1-shtancuesi/shpuesi, 2-unaza, 3-llamarina, 4-matrica,




Fig. 7. Vegla me pllakë udhëzuese, 1-dorëza, 2- pllaka e sipërme, 3-mbajtësi i veglës, 4-shtancuesi/shpuesi, 5- pllaka udhëzuese, 6-kufizuesi i llamarinës, 7- matrica, 8-detali i punuar




Fig. 8. Vegla e kombinuar me pllakë udhëheqëse dhe me shtylla, 1-pjesa e sipërme e veglës, 2- udhëzueset me shtylla, 3-shpuesi/shtancuesi, 4-matrica, 5-pjesa e poshtme mbështetëse e veglës

2. AKTIVITETET GJATË KONSTRUKTIMIT TË VEGLËS

2.1. MATERIALI BAZË

Llamarina në treg ndodhet në formë të tabakut ose e mbështjellur në formë tamburi me përmasa standarde.

Prerja e saj mund të bëhet në shirita, pllaka apo forma rrethore me anë të gërshërëve ose veglave tjera.

Materiali bazë për përpunimin e detaleve me shtancim dhe shpim është llamarina e cila i nënshtrohet procesit teknologjik:

- marrja e materialit nga depoja,
- drejtimi i materialit,
- pastrimi mekanik,
- shënimi,
- prerja e materialit në shirita,
- shpimi,
- shtancimi,
- kontrolli i detalit të prodhuar.

Llamarina para se ti nënshtrohet prerjes në shirita ka formën e tabelës me dimensione 2000x1000 [mm], në prodhimtarinë masovike llamarina është në tambur.



Fig. 9. Prerja e llamarinës në një repart prodhimi



Fig. 10. Prerja e llamarinës në shirita.

2.2. SHFRYTËZIMI EKONOMIK I MATERIALIT

Shpenzimet e materialit përfshijnë (40÷60)% të shpenzimeve totale, prandaj duhet ti kushtohet rëndësi e madhe zgjedhjes së varianteve me të cilat vjen deri te shfrytëzimi sa më i madh i materialit bazë (llamarinës). Variantet përfshijnë mënyrat e radhitjes të detalit në shirit (horizontale, vertikale, në pjerrtësi), mënyrat e prerjes së tabakut në shirita (sipas gjatësisë, sipas gjerësisë, e kombinuar), mënyrat e zvogëlimit të mbeturinave duke e shfrytëzuar konfiguracionin e detalit, etj.

Në fund zgjedhen ato variante të cilat japin numër më të madh të detaleve në tabelë e me këtë edhe shkallë më të madhe të shfrytëzimit të materialit.

2. 3. LLOJET E PRERJES SË SHIRITIT – LLOJET E HUMBJEVE TË MATERIALIT

Dallohen tri mënyra të prerjes së shiritit:

- prerja me mbeturina e materialit,
- prerja me mbeturina të vogla,
- prerja pa mbeturina.

Mbeturinat ndahen në dy grupe (fig. 11):

- mbeturinat me karakter konstruktiv (I) dhe
- mbeturinat me karakter teknologjik (II).

Mbeturinat me karakter konstruktiv fitohen gjatë shpimit të detalit, ndërsa në këtë grup bëjnë pjesë edhe mbeturinat që mbesin në fillim dhe në mbarim të shiritit. Këto mbeturina varen nga konfiguracioni i detalit dhe nuk varen nga shpërndarja e detalit në shirit.

Rëndësi shumë më të madhe për shfrytëzimin sa më racional të materialit kanë mbeturinat me karakter teknologjik. Këtu bëjnë pjesë humbjet e materialit për shkak të shtesave gjatësore e anësore dhe varen shumë nga shpërndarja e detaleve nëpër shirit dhe madhësia e shtesave.




Fig. 11. Mbeturinat me karakter konstruktiv (I) dhe teknologjik (II),
m dhe n – vlerat e madhësisë së shtesave

2.4. SHKALLA E SHFRYTËZIMIT TË MATERIALIT

Kjo shkallë rritet, me rritjen e numrit të rendeve horizontale ose vertikale, në shirit.

Shkalla e shfrytëzimit të materialit llogaritet me formulat:

$$\eta = \frac{A_0}{A_1} \cdot 100\%$$

$$\eta = \frac{A_0 \cdot i}{B \cdot L} \cdot 100\%$$

$$\eta = \frac{A_0 \cdot N}{B \cdot t} \cdot 100\%$$

ku janë:

$A_0 [mm^2]$ - sipërfaqja efektive e detalit,

$A_1 [mm^2]$ - sipërfaqja e nevojshme e shiritit për fitimin e një detali,

$B [mm]$ - gjerësia e shiritit,

$L [mm]$ - hapi i shiritit,

$t [mm]$ - gjatësia e shiritit,

i - numri i rendeve në shirit,

N - numri i përgjithshëm i detaleve të fituara nga një shirit.

2.5. FORCA E SHTANCIMIT DHE SHPIMIT

Forca e shtancimit - shpimit është në funksion të perimetrit të detalit që shtancohet – shpohet, trashësisë së materialit dhe sforcimit maksimal tangjencial:

$$F = L \cdot s \cdot \tau_m [N] = [mm \cdot mm \frac{N}{mm^2}] = [N]$$

ku janë:

$L [mm]$ - perimetri i pjesës së prerë,

$s [mm]$ - trashësia e materialit,

$\tau_m [N/mm^2]$ - sforcimi maksimal tangjencial.

Kur detali i shtancuar-shpuar ka formë rrethore me diametër d atëherë perimetri është:

$$L = \pi \cdot d ,$$

ndërsa forca për shtancim-shpim është:

$$F = \pi \cdot d \cdot s \cdot \tau_m \quad [N]$$

Nga formula vërehet se me rritjen e njërës nga komponentet e lartpërmendura rritet edhe forca e shtancimit - shpimit.

Puna e shtancimit - shpimit llogaritet me formulën:

$$W = x \cdot F \cdot s \quad [N \cdot mm]$$

x - koeficient i cili lexohet nga tabela 7.

Për shkak të konsumit të elementeve prerëse forca në bazë të së cilës zgjedhet makina (presa) rritet për 30%:

$$F_M = 1,3 \cdot F = 1,3 \cdot L \cdot s \cdot \tau_m \quad [N]$$

2.6. ZVOGËLIMI I FORCËS SË SHTANCIMIT DHE SHPIMIT

Në rastet kur duhet të shtancohen - shpohen detalet e trasha apo me perimetër të madh fitohet forca me vlerë të madhe, prandaj për zvogëlimin e kësaj force përdoren këto metoda:

- punimi i shtancuesit – shpuesit me gjatësi të ndryshme,
- pjerrtësimi i teheve të shtancuesit - shpuesit dhe matricës,
- nxehja e materialit bazë (llamarinës).

2.6.1. Punimi i shtancuesit – shpuesit me gjatësi të ndryshme

Me punimin e shtancuesit - shpuesit me gjatësi të ndryshme arrihet të zvogëlohet forca e shtancimit - shpimit pasi që eliminohet arritja e forcës maksimale të shtancimit - shpimit në të njëjtën kohë.




Fig. 12. Shpuesit dhe shtancuesit e punuar me gjatësi të ndryshme

2.6.2. Pjerrtësia e teheve të shtancuesit - shpuesit dhe matricës

Te shtancimi tehet e pjerrëta punohen në matricë sepse detali i prodhuar me shtancim mbetet i drejtë ndërsa pjesa tjetër e shiritit shtrembërohet. Te shpimi punohet pjerrtësia në shpues sepse detali i prodhuar me shpim është i drejtë.

Forca e shtancimit - shpimit për vegla me tehe të pjerrëta llogaritet me formulën:

$$F = k \cdot L \cdot s \cdot \tau_m [N]$$

Pra forca e shtancimit - shpimit zvogëlohet me koeficientin e zvogëlimit:

$$k = 0,4 \div 0,6 \text{ - për } H = s$$

$$k = 0,2 \div 0,4 \text{ - për } H = 2 \cdot s$$

Vlerat e pjerrtësisë janë:

$$H \leq 2 \cdot s \text{ dhe } \varphi \leq 5^\circ \text{ - për } s \leq 3[mm]$$

$$H = s \text{ dhe } \varphi \leq 8^\circ \text{ - për } s > 3[mm]$$

Puna e shtancimit - shpimit për vegla me tehe të pjerrëta llogaritet me formulën:

$$W = x_1 \cdot F \cdot (s + H)$$

$$x_1 = 0,5 \div 0,6 \text{ - për } H = s$$

$$x_1 = 0,7 \div 0,8 \text{ - për } H = 2 \cdot s$$

Në vazhdim do të analizohen disa raste për kushtet $H \geq s$ dhe $\varphi < 10^\circ$.

Shtancimi me formë të pjerrtësisë të matricës (fig. 13):




Fig. 13. Pjerrtësia e teheve prerëse të matricës

Forca e shtancimit të drejtkëndëshit (fig. 13):

$$F = 2,5 \cdot s \cdot \tau_m \cdot \left[a + 1,6 \cdot (1 + 0,05 \cdot \varphi) \cdot \frac{s \cdot \varepsilon_{ot}}{\operatorname{tg} \varphi} \right]$$

Forca e shtancimit të rrethit (fig. 13):

$$F = 2 \cdot (1 + 0,02 \cdot \varphi)^2 \cdot \frac{d \cdot s^2 \cdot \tau_m \cdot \varepsilon_{ot}}{H \cdot \sqrt{1 - \left(\frac{H - 0,2 \cdot s \cdot \varepsilon_{ot}}{H} \right)^2}}$$

Shtancimi me formë të pjerrtësisë të matricës (fig. 14):




Fig. 14. Pjerrtësia e teheve prerëse të matricës

Forca e shtancimit të drejtkëndëshit (fig. 14):

$$F = 2,5 \cdot s \cdot \tau_m \cdot \left[a + 1,6 \cdot (1 + 0,05 \cdot \varphi) \cdot \frac{s \cdot \varepsilon_{ot}}{\operatorname{tg} \varphi} \right]$$

Forca e shtancimit të rrethit (fig. 14)

$$F = 2,4 \cdot (1 + 0,02 \cdot \varphi)^2 \cdot d \cdot s \cdot \tau_m \cdot \arccos \frac{H - s \cdot \varepsilon_{ot}}{H}$$

Shpimi me formë të pjerrtësisë së shpuesit (fig. 15):




Fig. 15. Pjerrtësia e teheve prerëse të shpuesit

Forca e shpimit të drejtkëndëshit (fig. 15):

$$F = 2,5 \cdot s \cdot \tau_m \cdot \left[(1 + 0,03 \cdot \varphi) \cdot a + 1,6 \cdot (1 + 0,05 \cdot \varphi) \cdot \frac{s \cdot \varepsilon_{ot}}{\operatorname{tg} \varphi} \right]$$

Forca e shpimit të rrethit (fig. 15)

$$F = 2,4 \cdot (1 + 0,02 \cdot \varphi)^2 \cdot d \cdot s \cdot \tau_m \cdot \arccos \frac{H - s \cdot \varepsilon_{ot}}{H}$$

Shpimi me formë të pjerrtësisë së shpuesit (fig. 16):




Fig. 16. Pjerrtësia e teheve prerëse të shpuesit

Forca e shpimit të drejtkëndëshit (fig. 16):

$$F = 2,5 \cdot s \cdot \tau_m \cdot \left[a + 1,6 \cdot (1 + 0,05 \cdot \varphi) \cdot \frac{s \cdot \varepsilon_{ot}}{\operatorname{tg} \varphi} \right]$$

Forca e shpimit të rrethit (fig. 16) :

$$F = 2,4 \cdot (1 + 0,02 \cdot \varphi) \cdot d \cdot s \cdot \tau_m \cdot \arccos \frac{H - s \cdot \varepsilon_{ot}}{H}$$

2.6.3. Nxehja e materialit bazë (llamarinës)

Nxehja e materialit bazë bëhet në qoftë se:

- gjatë shtancimit – shpimit lajmërohen qarjet,
- materiali bazë nuk mund të përpunohet,
- forca e shtancimit – shpimit është e madhe.

2.7. QENDRA E RËNDESES SË VEGLËS

Shprehjet për llogaritjen e koordinatave të qendrës së rëndesës janë:

$$x_C = \frac{\sum_{i=1}^n F_i \cdot x_i}{\sum_{i=1}^n F_i} = \frac{\sum_{i=1}^n l_i \cdot s \cdot \tau_m \cdot x_i}{\sum_{i=1}^n l_i \cdot s \cdot \tau_m} = \frac{\sum_{i=1}^n l_i \cdot x_i}{\sum_{i=1}^n l_i}$$

$$y_C = \frac{\sum_{i=1}^n F_i \cdot y_i}{\sum_{i=1}^n F_i} = \frac{\sum_{i=1}^n l_i \cdot s \cdot \tau_m \cdot y_i}{\sum_{i=1}^n l_i \cdot s \cdot \tau_m} = \frac{\sum_{i=1}^n l_i \cdot y_i}{\sum_{i=1}^n l_i}$$




Fig. 17. Llogaritja e qendrës së rëndesës

2.8. HAPËSIRA NË MES TË SHTANCUESIT – SHPUESIT DHE MATRICËS

Më herët është treguar se udhëheqja e veglës e siguron hapësirën në mes teheve prerëse të shtancuesit – shpuesit dhe matricës, hapësirë kjo e nevojshme për rritjen e kualitetit të detaleve prodhuese dhe zvogëlimin e konsumit të elementeve prerëse (patricës dhe matricës).

Nga fig. 18 hapësira e njëanshme është:

$$f = \frac{D_m - D_p}{2} \quad [mm]$$

Ndërsa hapësira e dyanshme është:

$$w = 2 \cdot f = 2 \cdot \left(\frac{D_m - D_p}{2} \right) = D_m - D_p$$




Fig. 18. Hapësira në mes shtancuesit – shpuesit dhe matricës

Në varësi nga kjo hapësirë, kualitetit të detalit dhe dimensioneve të pjesës që shpohet – shtancohet, gjatë shtancimit dimensionet e shtancuesit dhe vrimës në matricë për shtancim janë:

$$D_{sht} = (D - \Delta - w)^{-\delta_s}$$

$$D_m = (D - \Delta)^{+\delta_m}$$

Gjatë shpimit:

$$d_{shp} = (d + \Delta)^{-\delta_s}$$

$$d_m = (d + \Delta + w)^{+\delta_m}$$

ku janë:

D [mm] – diametri i detalit të shtancuar,

d [mm] – diametri i vrimës së shpuar,

Δ [mm] – toleranca e përpunimit të detalit,

δ_m [mm] – toleranca e punimit të matricës,

δ_s [mm] – toleranca e punimit të shtancuesit – shpuesit.

Saktësia e punimit të pjesëve punuese të veglës është për tri kualitete më e mirë se saktësia e punimit të detalit.

Shtancuesi – shpuesi dhe matrica punohen njëri në raport me tjetrin me këto toleranca:

$$\frac{\text{matrica}}{\text{shtancuesi} - \text{shpuesi}} = \frac{H7}{h6}; \frac{H8}{h7}; \frac{H9}{h8} \text{ etj.}$$

2.9. MATERIALET E VEGLAVE

Materialet e veglave ndahen në:

- materialet konstruktive,
- materialet për elemente punuese.

Struktura mbajtëse e veglës punohet nga materialet konstruktive (çeliqet karbonike, çeliqet për çimentim).

Elementet punuese të veglës punohen nga çeliqet e leguruara, ashtu që fortësia e matricës duhet të jetë $(2 \div 4)$ HRC më e madhe se fortësia e shtancuesit – shpuesit, p.sh. për shtancues – shpueset merret X210CrW12 ndërsa për matricë X6Cr13.

2.10. MATRICA PËR SHTANCIM – SHPIM

Matrica së bashku me shtancuesin – shpuesin janë pjesët më të rëndësishme të veglës. Në matricë hapen të gjitha vrimat për shpim – shtancim, për shtrëngim, për centrim. Largësia mes vrimave në matricë varet nga fortësia e saj, largësia në mes vrimave rritet me rritjen e fortësisë së matricës. Për detalet me përmasa të mëdha matrica punohet prej shumë pjesëve (matrica e segmentuar). Shikuar nga dimensionet gabarite të matricës, matricat këndore me dimensione 200×250 [mm] ose ato rrethore deri në $\varnothing 300$ [mm] punohen prej një pjese ndërsa matricat me dimensione mbi vlerat e lartpërmendura punohen prej shumë pjesëve.




Fig. 19. Profilet e vrimave në matricë

Vlerat e h, α lexohen nga tabela 4.




Fig. 20. Mënyrat e fiksimit të matricës

2.10.1. Llogaritja e dimensioneve të matricës

Trashësia e matricës llogaritet sipas formulës:

$$H_m = (10 + 5 \cdot s + 0,7 \cdot \sqrt{a+b}) \cdot C \text{ [mm]}$$




Fig. 21. Dimensionet e matricës

C– koeficient i cili varet nga sforcimi σ_m , lexohet nga tabela 5.

Gjerësia e skajit të matricës:

$$e = (10 \div 12) + 0,8 \cdot H_m \text{ [mm]}$$

Dimensionet e matricës janë:

$$A = a + 2 \cdot e \text{ [mm]} - \text{gjatësia e matricës}$$

$$B = b + 2 \cdot e \text{ [mm]} - \text{gjerësia e matricës}$$

Po ashtu kujdes duhet ti kushtohet edhe distancës në mes së skajeve të vrimave për shtrëngim dhe vrimave për centrim. Vlera e distancës varet prej madhësisë së bulonit dhe kunjave si dhe gjendjes së matricës (e kalitur ose e pa kalitur).





Fig. 22. Matrica dhe operacionet në shirit

Madhësia e filetës zgjidhet në varësi nga trashësia e matricës (fig. 23)



T	<13	13~19	19~25	25~32	≥ 32
M	M4, M5	M5, M6	M6, M8	M8, M10	M10, M12

Fig. 23. Madhësia e filetës




Fig. 24. Distanca e qendrës së filetës nga skajet e matricës





Fig. 25. Distanca në mes qendrave të filetës



Madhësia e filetës	M3	M4	M5	M6	M8	M10	M12
D1	6.5	8.0	9.5	11.0	14.0	17.5	20.0
H (Minimum)	3.5	4.5	5.5	6.5	8.5	11.0	13.0
d1	3.4	4.5	5.5	7.0	9.0	11.0	14.0
A	Madhësia e filetës x (1,5 deri 2,5)						
B	Madhësia e filetës x 3 ose më e vogël						
d2	2.6	3.4	4.3	5.1	6.8	8.5	10.3

Fig. 26. Dimensionet dhe vendosja e bulonit në pllakë

Vendosja e kunjit në pllakë është treguar në fig. 27:

$$D \leq L \leq 3 \cdot D$$

$$D \leq B \leq 2,5 \cdot d$$




Fig. 27. Vendosja e kunjit për centrim dhe parametrat e tij gjeometrik

2.11. SHTANCUESIT DHE SHPUESIT

Shtancuesi - shpuesi së bashku me matricën bëjnë prerjen e materialit. Prerja tërthore e shtancuesit - shpuesit varet në tërësi nga konfiguracioni i detalit që duhet të prodhohet. Që të pengohet rënia e shtancuesit – shpuesit nga mbajtësi, punohen më të trashë në njërën anë. Gjatësia e shtancuesit – shpuesit është $(60 \div 100)$ [mm]. Shtancuesit me dimensione të mëdha shtrëngohen me bulona dhe qendërzohen me kunjja në pllakën e epërme ndërsa shtancuesit dhe shpuesit me dimensione të vogla shtrëngohen me anë të pllakës mbajtëse në pllakën e epërme. Variantet më të shpeshta të shpuesëve janë treguar në fig. 28 dhe 29.

Forma e shpuesve dhe shancuesve i përgjigjet formës dhe madhësisë së detalit që punohet. Pra, dallojmë:

- shtancues me një teh prerës,
- shtancues me dy tehe prerëse,
- shtancues me tehe prerëse në tërë sipërfaqen ballore,
- shpues.




Fig. 28. Variantet e shpuesve



Fig. 29 Forma të ndryshme të shpuesëve/shtancuesve

Disa mënyra të fiksimit të shpuesve dhe shtancuesëve janë paraqitur në figurën 30.




Fig. 30. Mënyrat e fiksimit të shpuesve

Gjatësia e shtancuesit – shpuesit llogaritet në mënyrë të saktë me formulën:

$$L_{sht-shp} = H_m + H_{pu} + H_{pm} + (10 \div 20) [mm]$$

ku janë:

H_m - trashësia e matricës,

H_{pu} - trashësia e pllakës udhëheqëse,

H_{pm} - trashësia e pllakës mbajtëse.

2.11.2. Llogaritja e shtancuesit dhe shpuesit në shtypje

Kushtin që duhet ta plotësojnë shtancuesit dhe shpuesit në shtypje është:

$$\sigma_{sh} = \frac{F}{A} \leq (\sigma_{sh})_{lej} [N/mm^2]$$

ku janë:

$F [N]$ – forca e shtancimit – shpimit,

$A [mm^2]$ – sipërfaqja e prerjes tërthore e shtancuesit – shpuesit,

$(\sigma_{sh})_{lej}$ - sforcimi i lejuar në shtypje për çelik të farkëtuar

1000 ÷ 1600 $[N/mm^2]$.

Për shpimin e vrimave me dimensione të vogla në llamarinat me trashësi të madhe sforcimi i lejuar në shtypje merret $(\sigma_{sh})_{lej} = 1200 [MPa]$ për të gjitha materialet me $\tau_m > 300 [MPa]$.

2.11.3 Llogaritja në epje

Shpuesit e gjatë dhe të hollë shqyrtohen në epje, ku gjatë shqyrtimit llogaritet gjatësia maksimale e lirë e shpuesit, shqyrtimi kryhet në varësi të udhëheqjes së shpuesit.




Fig. 31. Epja e shpuesit pa udhëheqje a) dhe me udhëheqje b)

Për shpuesin e ngurtësuar vetëm në një rënë anë, nisemi nga barazimi i forcës kritike të epjes me forcën e shpimit:

$$F_{kr} = F_{shp}$$

$$\frac{\pi^2 \cdot E \cdot I_{\min}}{4 \cdot l^2} = L \cdot s \cdot \tau_m \Rightarrow l_{\max} = \sqrt{\frac{\pi^2 \cdot E \cdot I_{\min}}{4 \cdot L \cdot s \cdot \tau_m}}$$

ku janë:

$E [N/mm^2]$ - moduli i elasticitetit për çelik $E = 215000 [N/mm^2]$,

$I_{\min} [mm^4]$ - momenti më i vogël i inercisë,

$l [mm]$ - gjatësia e lirë e shpuesit,

$L [mm]$ - perimetri i pjesës që shtancohet - shpohet,

$s [mm]$ - trashësia e materialit,

$\tau_m [N/mm^2]$ - sforcimi tangjencial i materialit.

Për shpuesin e udhëhequr me pllakë udhëheqëse forca kritike është:

$$F_{kr} = \frac{2 \cdot \pi^2 \cdot E \cdot I_{\min}}{l^2} [N]$$

Nëse kjo forcë barazohet me forcën e shpimit kemi:

$$F_{kr} = F_{shp}$$

$$\frac{2 \cdot \pi^2 \cdot E \cdot I_{\min}}{l^2} = L \cdot s \cdot \tau_m \Rightarrow l_{\max} = \sqrt{\frac{2 \cdot \pi^2 \cdot E \cdot I_{\min}}{L \cdot s \cdot \tau_m}}$$

Shtypja në shpues llogaritet:

$$\sigma_{SH} = \frac{F}{A} = \frac{\pi \cdot d \cdot s \cdot \tau_m}{\pi \cdot d^2} \left[\frac{N}{mm^2} \right]$$

$$A = \frac{\pi \cdot d^2}{4} \quad \text{- sipërfaqja cilindrike}$$

$d [mm]$ - diametri më i vogël i lejuar i vrimës që shpohet.

$\tau_m \left[\frac{N}{mm^2} \right]$ - sforcimi tangjencial i materialit që shpohet.

2.12. PLLAKA UDHËHEQËSE

Me pllakë udhëheqëse realizohet udhëheqja e shtancuesit dhe shpuesit. Vrimat në pllakën udhëheqëse janë të njëjta si në matricë por me hapësirë më të vogël. Toleranca e përshtatshme në mes shtancuesit – shpuesit dhe pllakës udhëheqëse është H7/h6. Materiali i pllakës udhëheqëse është çelik konstruktiv. Sipërfaqet e pllakës udhëheqëse duhet të retifikohen. Trashësia e pllakës udhëheqëse llogaritet me anë të formulës:

$$H_{pu} = (0,8 \div 1) \cdot H_m \text{ [mm]}$$

2.13. PLLAKA MBAJTËSE

Me pllakën mbajtëse mundësohet shtrëngimi dhe mbajtja e shtancuesëve dhe shpuesve. Ka të njëjtat vrima si matrica. Trashësia e pllakës mbajtëse llogaritet me anë të formulës:

$$H_{pm} = (0,6 \div 0,8) \cdot H_m \text{ [mm]}$$




Fig. 32. Pllaka mbajtëse

Shtrëngimi i pllakës mbajtëse me pllakën e epërme bëhet me bulona, ndërsa te veglat me shtylla udhëheqëse duhet të bëhet edhe qendërzimi nga pllaka e epërme me anë të kunjave të posaçëm.

2.14. NDËRMJETPLLAKA

Për zvogëlimin e shtypjes specifike ndërmjet pllakës së epërme dhe shtancuesit – shpuesit vendoset ndërmjetplaka. Vlerësimi se a duhet të vendoset ndërmjetplaka bëhet me anë të formulës:

$$p = \frac{F}{A} \leq p_{lej} [N/mm^2]$$

ku janë:

$F [N]$ - forca e shtancimit – shpimit,

$A [mm^2]$ - sipërfaqja që shtancohet – shpohet,

$p_{lej} = 250 [N/mm^2]$ - shtypja specifike e lejuar.

Nëse plotësohet kushti $p \leq p_{lej}$ atëherë nuk është e nevojshme vendosja e ndërmjetplakës.




Fig. 33. Ndërmjetplaka

Materiali i ndërmjetplakës është Č0650 ose Č0750 me trashësi $(2 \div 8)$ [mm], ndërsa sipërfaqja e epërme dhe e poshtme e ndërmjetplakës duhet të retifikohet.

2.15. ELEMENTET PËR PËRCAKTIMIN E GJATËSISË SË HAPIT TE LËVIZJA ME DORË E SHIRITIT

Gjatë përpunimit me shpim – shtancim pas çdo goditje shiriti lëviz për një hap, hapi duhet të jetë i saktë e sidomos te veglat progresive. Në varësi nga saktësia e udhëheqjes përcaktimi i hapit mund të kryhet me:

- kufizues,
- centruer,
- kufizues (thika) anësore,
- kufizues fillestar.

Në këtë tekst është shtjelluar përcaktimi i gjatësisë së hapit me anë të centruerëve dhe kufizuesve (thikave) anësore.

2.15.1. Centruerit

Centruerit përdoren për përmirësimin e gabimeve që lindin gjatë mbështetjes së dobët të shiritit në kufizuesit për udhëheqje të shiritit. Centruerit është më i gjatë se shtancuesi ashtu që centruerit hyn më parë në vrimën që është shpuar dhe bënë vendosjen e shiritit në pozitë të drejtë e pastaj shtancuesi e takon llamarinën. Centruerit për llamarinat më trashësi më të vogël se 0,25 [mm] nuk përdoren sepse mund të vie deri te përkulja e llamarinës. Format e centruerit janë të ndryshme (fig. 34).




Fig. 34. Format e centruerëve dhe dimensionet

Gjatësia e centruesve llogaritet me formulën:

$$l_1 = L_{sht-shp} + s \text{ [mm]} - \text{për } s < 1 \text{ [mm]}$$

$$l_1 = L_{sht-shp} + \frac{2}{3} \cdot s \text{ [mm]} - \text{për } s > 1 \text{ [mm]}$$

Centruesi mund të punohet së bashku me shtancuesin apo ndaras me atë.

2.15.2. Kufizuesit (thikat) anësor

Kufizuesit anësor përdoren kur kërkohet saktësi më e madhe e detalit ose kur trashësia e llamarinës është më e vogël se 0,3 [mm]. Me përdorimin e kufizuesve anësor duhet të merret parasysh edhe shtesa (c) që duhet të shtancohet e që është në funksion të trashësisë së llamarinës. Dy kufizues anësor përdoren në rastet kur duhet të shtancohen pjesët e ngushta dhe të gjata.




Fig. 35. Përpunimi me dy kufizues anësor

2.16. KONSTRUKTIMI I VEGLËS




Fig. 36. Zgjidhja ideale e veglës

